

VENDIM
Nr. 843, datë 2.11.2012

PËR KRIJIMIN E SHTËPISË BOTUESE TË TEKSTEVE MËSIMORE (BOTEM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e personit juridik publik “Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM)”, si institucion buxhetor në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. Misioni i Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore është botimi, shpërndarja dhe shitja e teksteve mësimore të arsimit profesional, teksteve të pakicave kombëtare, diasporës, teksteve me tirazh të ulët në sistemin arsimor parauniversitar dhe i materialeve të tjera ndihmëse.

3. Detyrat kryesore të BOTEM-ës janë:

a) Botimi dhe shpërndarja e teksteve të lëndëve profesionale për shkollat e arsimit profesional;

b) Botimi dhe shpërndarja e teksteve në gjuhën amtare dhe teksteve të veçanta historike e kulturore për shkollat e pakicave kombëtare;

c) Botimi i moduleve profesionale dhe teksteve të veçanta të kurrikulës me zgjedhje në shkollat e arsimit parauniversitar;

ç) Botimi i teksteve të veçanta, që hyjnë në procesin mësimor-edukativ në zbatim të marrëveshjeve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me subjekte të huaja;

d) Botimi i teksteve të veçanta për diasporën.

4. Shtypja e teksteve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, realizohet nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a., me kapital shtetëror, në varësi të Ministrisë së Financave.

5. Për secilin tekst mësimor, Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM) formon grupet e autorëve, komisionet e posaçme për diskutimin dhe miratimin e teksteve, si dhe organizon fillimin e procedurës së botimit. Anëtarët e grupeve dhe komisioneve paguhën sipas akteve nënligjore në fuqi.

6. Statuti dhe rregullorja e Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

7. Procedurat e botimit, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve të arsimit profesional, teksteve në gjuhën amtare dhe teksteve të veçanta historike e kulturore për shkollat e pakicave kombëtare, si edhe të teksteve të veçanta për diasporën, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

8. Çmimi i shitjes së teksteve, të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, përcaktohet në bazë të metodologjisë së parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Drejtuesi i Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose Ministrit”.

10. Struktura dhe organika e BOTEM-ës miratohen me urdhër të Kryeministrit.

11. Numri i punonjësve të BOTEM-ës të jetë i përfshirë në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

12. Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM) është institucion buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i BOTEM-ës derdhen në Buxhetin e Shtetit.

13. Buxheti i planifikuar për Shtëpinë Botuese të Librit Universitar, të gjitha asetet dhe detyrimet e saj i kalojnë Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore (BOTEM).

14. Vendimi nr. 437, datë 20.12.1986 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Shtëpisë Botuese të Librit Universitar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

15. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha